



CENSURA PRAPAVAJTËSE

Ardian Vehbiu

Një nga reagimet që erdhën, pas botimit të shkrimit të Auron Tares për Koliqin dhe Camajn në “Peizazhe të fjalës” këtë vit në verë, ishte: “nuk duhet të ishte botuar.”

I njëjti reagim, këtë herë pas një shkrimi tejet kritik nga Adri Kalaja për veprën “E pafilozofuara” dhe autorin e saj, Hysamedin Feraj, nga një koleg i këtij: “nuk duhet të ishte botuar.”

Njëlloj për një shkrim të Bardhyl Demirajt para ca muajsh, ku qortohej, mbase ashpër, nismëtari i botimit të një libri për Camajn.

Mes komenteve që ndoqën ribotimin e shkrimit të Tannhauser-it për Dropullin, ky reagim shfaqej herë pas here: “Nuk duhet të ishte botuar”.

Po çfarë është kjo “nuk duhet të ishte botuar”, përveçse një rikthim – i çiltër – i dëshirës për censurë? Vetëm se ndryshe nga censura e mirëfilltë, që vjen në trajtën imperative “të mos botohet”, nga autoriteti që vendos për botimin, kjo tjetra ndërtohet rreth foljes modale DUHET.

E cila parakupton, në analizë të fundit, një rregull a një ligj të nënvendosur, të cilit po i kërkohet zbatimi.

Të jenë kthyer bulldogët e policisë intelektuale?

Pastaj, mu kur po i mendoja këto shënime, lexova letrën e Orwellit, për [Lirinë e Shtypit](#), që pat sjellë tek ne të përkthyer Sokol Çunga, me rastin e botimit të *Fermës së Kafshëve* në shqip tani së fundi.

Orwell-i shpjegon se kjo lloj censure, që ishte shfaqur edhe në Britaninë e Madhe të asaj kohe, lidhet me frikën ndaj opinionit publik.

Kolegut që më pat thënë se eseja për Hysamedin Ferajn nuk duhej të ish botuar, iu përgjigja pak a shumë kështu: nuk do të ishte më mirë, sikur të uleshe të bëje ti gati një përgjigje për çfarë thua, dhe të argumentoje pse autori i shkrimit të parë e kish gabim?

A nuk do të ishte i preferueshëm debati ndaj heshtjes? A nuk do të ishte mirë që opinionin tuaj *ex cathedra*, se shkrimi nuk duhej të ishte botuar, ta mbështetnit me argumente (të cilat me siguri i keni), në mënyrë që të bindeshin edhe lexuesit e shkrimit origjinal se ky nuk qëndronte?

Përshtypja ime: Këta që thonë “nuk duhet të botohej”, sikur kanë parasysh një sistem të etabluar të dijes, por edhe të opinioneve, i cili nuk duhet prekur; sepse është **aq i dobët**, sa mjafton një e prekur për ta rrëzuar. Si ato pallatet që i ndërton me letra bixhozi.

Këta me gjasë e identifikojnë dijen dhe kulturën me *statu quo*-në; tërthorazi, në atë masë që identifikohen me *statu quo*-në, e ushtrojnë pushtetin që kanë – që kujtojnë se kanë – duke përqafuar opinione të caktuara.

Edhe sikur *statu quo*-ja, si në rastin e kombëtarizmit folk, të konsistojë në një koleksion narrativash naive, në mos infantile; sa kohë që me të do të merrte të krisur edhe kapitali i tyre intelektual, madje edhe pushteti që kanë (intelektual, por jo doemos).

Nuk duhet, të thonë. Duke parakuptuar që kjo duhet ka një lloj vlerë edhe për ty, si imperativ kolektiv që është. Me fjalë të tjera – duke botuar, ose duke ia dhënë një produkt kulturor publikut, edhe ti në mënyrë implicite i nënshtrohesh këtij imperativi folklorik, sepse botimi – ose nxjerrja e një teksti në botë – parakupton edhe nënshttrimin ndaj rregullave të kësaj bote.

Përndryshe, në jetën dhe në hapësirën publike të shqiptarëve nuk është se mungon kritika, edhe ajo negative, edhe ajo *ad hominem*, edhe jo fyese dhe poshtëruese dhe shpifëse. E gjen ngado që të kthehesh – por vetëm në sferën e politikës. Gazetat, rrjetet sociale, televizioni kultivojnë këtë diskurs që gjithnjë ka tone të forta kritike, madje themelohet mbi kritikën ndaj Tjetrit. Politikanët konstituohen edhe në bazë të kritikave dhe sulmeve që u kanë bërë, të tipareve të tyre të kritikuara dhe të kritikueshme. Mjaft të pyesësh: çfarë është Edi Rama për kundërshtarët e tij? Përgjigjja: tërësi e kritikave që i janë bërë dhe i bëhen. Natyrisht, politikanët mbahen gjallë falë një sistemi të tillë polarizues.

Kjo ndoshta krijon pastaj iluzionin se, të kritikosh diçka haptazi, jashtë sferës banale të politikës, do të thotë **ta politizosh**. (Në kuptimin që, t’i biesh dikujt, është si t’i japësh licencën për të të rënë ai ty.)

Pozicioni është populist dhe, në thelb, antipolitik – teksa i referohet edhe kombëtarizmit, që shihet si tërësi bindjesh dhe opinionesh morale të miratuara.

Të tipit: Kristo Frashëri, *i mirë*; Oliver Jens Schmitt-i, *i keq*.

Censura e tipit “nuk duhet të ishte botuar” kërkon shmangie të konfliktit, dhe lë të kuptohet se, të paktën në një fushë të caktuar, versionet dhe pozicionet tashmë kanë pasur aq kohë të kristalizohen, sa të fillojnë të orkestrojnë konformimin total.

Madje duke u kristalizuar, të bëhen pjesë e identitetit modern të shqiptarit.

Ndoshta ky imperativ kaq foshnjor, kjo dëshirë dythundrake për shmangien e konfliktit, ka bërë edhe që kultura – si skenë e gjallërisë së mendimit artistik dhe intelektual të qytetarëve – të zëvendësohet nga një burokraci e mirëmbajtjes së traditës dhe të kalendarit, një kult i së shkuarës, një riprodhim i ritualizuar i cjepërve përçorë a i “shenjtorëve” shekullarë që është, në fakt, edhe riprodhim i hierarkive.

Shto këtu parazitimin mbi vlera që nuk i kemi krijuar vetë.

Shto këtu konceptimin e kulturës dhe komunikimit kulturor si koleksion platitudash dhe truizmach: *ah, i madhi Dante!*

Diskursi i sotëm publik, në Shqipërinë përtej politikës, është diskursi i atyre që nuk duan rrezikojnë asgjë. Kjo nuk ka lidhje me atë që, të njëjtët persona nuk lodhen së shari e së pështyri, kur është fjala për të diskredituar kundërshtarin politik. Kur flas për rrezikim, kam në mendje tabutë. Kam në mendje frikën ndaj tabuve. Kam në mendje frikën ndaj atyre që të bien kokës me librin e madh të tabuve.

Në analizë të fundit, frikën mos ti përfundon në listën e zezë, që është edhe ajo një renditje tabush.

Ka vite tashmë që establishmenti kulturor, tek ne, po merret me instaurimin dhe mirëmbajtjen e tabuve.

Kritika e mirëfilltë, e cila ndonjëherë thotë edhe “kjo vepër fituese e çmimit X është, në fakt, shumë e dobët” dhe pastaj të argumentojë psetë, vetvetiu i trazon ujërat dhe hierarkitë. Një paragraf në një revistë letrare mund të shkaktojë një dorëheqje me impakt ballkanik.

Por jo anasjelltas.

Nuk është vendi që të shpjegoj dobitë e kritikës negative për kulturën; por edhe nuk rri dot pa thënë se një kritikë negative e fortë dhe e argumentuar funksionon edhe si **censurë profilaktike**, duke shkurajuar vepra të ngjashme në të ardhmen.

Për shembull, në qoftë se një shkrim kritikohet pse ka përdorur një rrejshmëri logjike (p.sh. *selection bias*), atëherë autorët do ta shmangin këtë lloj shkarjeje në të ardhmen.

Këta që të thonë nuk duhet, kërkojnë të kundërtën: censurën prapavajtëse, duke tërhequr vëmendjen e publikut se aksh vepër ose artikull, që është botuar, në fakt nuk duhet të ishte botuar. Vepra ose artikulli ende qarkullojnë, por të pushkatuara.

Dhe jo vetëm: duke dhënë dënime publike, në trajta kinse të pafajshme, të tipit “ky është mendimi im, ti mund të kesh mendim tjetër”, nuk e vënë re paradoksin – sikur shkrimi të mos ish botuar vërtet, ti nuk do të kishe rastin ta formuloje gjykimin tënd dhe as – e rëndësishme – të pozicionoheshe si *enforcer* i statu quo-së në kulturë.

E gjithë kjo lidhet ngushtë sa me shpalljen e pashpallur të kombëtarizmit si vlerë rifuxhio, aq edhe me idenë e çuditshme – dhe paralizuese – se gjithçka që bëjmë, e bëjmë “për këtë tokë”; ose, për ta thënë ndryshe, se “jemi të gjithë në shërbim të atdheut”.